

VEGJETARIANIZMI SI IDENTITET SOCIAL DHE ROLI I TIJ NË RUAJTJEN
E MJEDISIT

TEMA PËR TITULLIN
MASTER I ARTEVE NË SOCIOLOGJI

EKSPOZE E PUNIMIT TË TEMËS SË MASTERIT

NGA

LEONORA BOGUJEVCI



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENTI I SOCIOLOGJISË
PRISHTINË

KORRIK, 2022

VEGJETARIANIZMI SI IDENTITET SOCIAL DHE ROLI I TIJ NË RUAJTJEN E MJEDISIT

Mentor: Prof. Ass. Dr. Gëzim Selaci

Kandidate: Leonora Bogujevci

Punimi “Vegjetarianizmi si identitet social dhe roli i tij në ruajtjen e mjedisit” mbrohet nga Leonora Bogujevci për marrjen e gradës Master i Arteve në Sociologji.

Qëllimi i këtij studimi është t’i analizojë qëndrimet, t’i identifikojë shprehjet, tendencat e vegjetarianëve në Kosovë dhe të analizojë rolin e vegjetarianëve në raport me mjedisin dhe angazhimin e tyre në lëvizjet mjedisore.

Metodologjia e përdorur

Për të realizuar këtë punim është bërë një hulumtim teorik dhe empirik mbi temën ku në pjesën empirike janë përdorur metodat kualitative me intervistën gjysmë të strukturuar, analizën e përmbajtjes dhe vëzhgimin si instrumente. Punimi nisët nga këto pyetje hulumtuese:

- Si ndikon vegjetarianizmi në vetëdijen ekologjike?
- A është vegjetarianizmi identitet social?
- Cilat janë qëndrimet, sjelljet dhe shprehjet e vegjetarianëve ndaj ambientit?
- Sa është i përhapur ky komunitet, a ka paragjykime kundrejt tyre dhe cilat janë ato?

Hipoteza e hulumtimit është se aktivizimi dhe angazhimi i vegjetarianëve ndikon në përmirësimin e mirëmbajtjes së ambientit gjithashtu edhe ndërgjegjësimi i të tjerëve për këtë lloj stili të jetesës ka ndikim në ekologji.

Struktura e këtij punimi është e ndarë në tetë (8) kapituj, që paraqiten shkurtimisht në vijim:

Kapitulli i parë: Në këtë kapitull është hyrja e punimit që flet në përgjithësi rreth vegjetarianizmit dhe mjedisit, tregohet interesi dhe origjinaiteti për temën si dhe paraqitet qëllimi, hipoteza dhe metodologjia e përdorur.

Kapitulli i dytë: Në këtë kapitull është paraqitur metodologjia e gjithë punimit, ku jepen detaje mbi hulumtimin teorik dhe empirik. Këtu elaborohen në detaje procedura e metodologjisë

duke përfshirë informata mbi atë se si është konstruktuar hulumtimi, cilët kanë qenë pjesëmarrësit dhe si janë formuluar dhe analizuar intervistat.

Kapitulli i tretë: Në këtë kapitull është pjesa e hulumtimit teorik ku elaborohet vegjetarianimi si identitet social, besimet dhe qendrimet që lidhen me identitetin vegjetarian, vegjetarianizmi dhe ndikimi i tij në mirëqenien psikologjike si dhe i vihet theks vegjetarianizmit si një lëvizje e re sociale

Kapitulli i katërt: Në këtë kapitull është pjesa e teorisë rreth ambientit dhe problemeve mjedisore ku paraqitet filozofia ambientaliste, shkencë ambientaliste, problemet mjedisore. Poashtu, paraqitet edhe korniza ligjore në Kosovë e cila rregullon aspektin e mbrojtjes së natyrës, mjedisit dhe biodiversitetit; Këtu paraqiten edhe disa raporte mbi situatën e mjedisit në Kosovë dhe puna e shoqërisë civile në raport me mjedisin.

Kapitulli i pestë: Në këtë kapitull janë paraqitur rezultatet nga hulumtimi empirik ku fokusi kryesor është tek rezultatet që kanë dalur nga pjesa e observimit. Interpretohen në detaje pjesa e ndikimit të vegjetarianëve në vetëdijen ekologjike dhe ruajtjen e ambientit si dhe avokimi i OJQ-ve për vegjetarianizmin.

Kapitulli i gjashtë: Në këtë kapitull janë paraqitur rezultatet nga pjesa e analizës së përmbajtjes ku interpretohet se si qëndron roli i vegjetarianëve aktivistë në Kosovë në raport me mjedisin dhe në aktivitetet mjedisore.

Kapitulli i shtatë: Në këtë kapitull janë paraqitur rezultatet nga pjesa e intervistave ku të gjeturat ndahen në tri kategori kryesore si: Qëndrimet, bindjet dhe praktikat vegjetariane.

Kapitulli i tetë: Në këtë kapitull janë paraqitur përfundimi dhe rekomandimet. Këtu është bërë një përmbledhje nga të gjeturat e gjithë hulumtimit duke dhënë pastaj rekomandimet kryesore.